



## **Koalicija Za Gora**

**Pasqyrat Financiare Vjetoredhe Raporti i Auditorëve të pavarur**

**01 Janar2015 - 31 Dhjetor 2015**

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.. ..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-13

# Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Koalicija Za Gora

## Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit politik **Koalicija Za Gora** (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “KZAG” apo “SP”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2015, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e mbyllur me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 8-12.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinion të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2015, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 „Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

### Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Ashtu siç prezantohet ne Pasqyrën e Pozitës Financiare Subjekti politik nuk ka bartur te gjithë suficitin e vitit te mëparshëm ne vitin aktual, ne kemi konstatuar qe SP ka nënvlerësuar fondet e barturapërvlerën 3,211.58 Euro me 31 Dhjetor 2015.
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2 , Subjekti Politik ka deklaruar vlerën e aseteve 11,299.73 Euro me 31 Dhjetor 2015, përderisa te hyrat e shtyra te ndërlidhura direkt me vlerën e aseteve janë 8,508.48 Euro. Gjate auditmit ton ne kemi konstatuar që SP ka nënvlerësuar te hyrat e shtyra për 2,791.25 Euro me 31 Dhjetor 2015.
- Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime ne Pasqyrën e te Ardhurave dhe Shpenzimeve ne vlerë 33,627.96 Euro, gjate auditmit ton ne kemi konstatuar

qe shpenzimet e deklaruar nuk përputhen me shpenzimet e shpallura në shënimin 2 për vlerën 2,127.45 Euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015.

### **Theksim i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Koalicioni “KoalicijaZaGora” është formuar në marveshtjen e nënshkruar me datën 12.05.2014 në mes SP JedinstvaGoranski Partia – JGP dhe Građanska Inicijativa Gore-GIG. Në pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve SP shpenzimet të deklaruar janë faturuar në emër të partive të koalicionit e jo në emër të koalicionit KoalicijaZaGora.
- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t’u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalljes, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të

likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të

mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Contosh.p.k

---

Elmije Osmani  
Auditor Ligjor  
29Nëntor 2017

**Pasqyra e Pozitës Financiare**

	Shënime	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma ne Euro	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma ne Euro
<b>PasuritePasurite afatgjata</b>			
Toka, objektet dhe pajisjet	2	11,299.73	11,229.10
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>11,299.73</b>	<b>11,229.10</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>		0.00	0.00
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	2,305.94	6,738.64
Pasuritë tjera afatshkurtra		-	-
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>2,305.94</b>	<b>6,738.64</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>13,605.67</b>	<b>17,967.74</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		3,527.06	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		1,570.13	6,738.64
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>5,097.19</b>	<b>6,738.74</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		8,508.48	11,229.00
<b>Gjithsej detyrimet agatgjata</b>		<b>8,508.48</b>	<b>11,229.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		0.00	0.00
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra		-	-
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>8,508.48</b>	<b>11,229.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>13,605.67</b>	<b>17,967.74</b>

**Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti qe përfundon me 31.12.2015	Viti qe përfundon me 31.12.2014
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		30,725.00	17,750.00
Të hyrat nga anëtarësia		-	-
Donacionet dhe kontributet në të holla			
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		-	-
Të hyrat e fushatës		-	-
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	2	2,127.12	1,330.00
Të hyrat tjera		2,345.97	1,263.34
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>35,198.09</b>	<b>20,343.34</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	4	12,957.45	3,152.23
Shpenzimet e transportit	4	7,738.50	3,188.72
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	4	1,976.00	1,262.34
Shpenzimet e fushatës	4	-	-
Blerja e mallrave	4	2,706.25	724.98
Shpenzimet e përgjithshme	4	7,306.20	3,894.89
Shpenzimet e ndryshme	4	943.56	1,381.54
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>33,627.96</b>	<b>13,604.70</b>
<b>Suficiti (deficiti) për vitin</b>		<b>1,570.13</b>	<b>6,738.64</b>



## **1. Informata te përgjithshme**

KoalicijazaGora pajtim me Nenin 15.5, Neni 25 dhe 63.4 të Ligjit nr. 03 / L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Neni 6.3 i Rregullores Zgjedhore nr. 08/2013 Konfirmimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre dhe neni 3 i rregullores zgjedhore 15/2013 Zgjedhjet e jashtëzakonshme . KQZ ka marr vendim për formimin e KoalicijazaGora me daten 19.05.2014.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.

KoalicijazaGora është regjistruar me datën 01.10.2014 me këtënumër fiskal 601164859 certifikata e lëshuar nga ATK-ja.

Adresa e SP : Rruga e Broditpn Dragash

Kryetari i KoalicijazaGora Adem Hoxha

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën RBKO.

**Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////		<b>0.00</b>
Objektet					<b>0.00</b>
Veturat	5,358.00	0.00	0.00	1,071.60	<b>4,286.40</b>
Pajisjet e zyrës	1,838.50	2,197.75	0.00	249.00	<b>3,787.25</b>
Pajisjet e teknologjisë informative	3,914.20	0.00	0.00	782.84	<b>3,131.36</b>
Pajisjet tjera	118.40	0.00	0.00	23.68	<b>94.72</b>
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>11,229.10</b>	<b>2,197.75</b>	<b>-</b>	<b>2,127.12</b>	<b>11,299.73</b>

**Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

	Me 31 Dhjetor 2015 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro
Paraja në bankë	2,305.94	6,738.64
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>2,305.94</b>	<b>6,738.64</b>

**Shënimi 4: Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	<b>Shpenzimi në Euro</b>	<b>Pagesa në Euro</b>	<b>Borxhi i mbetur në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	10,444.65	10,444.65	
Kontributet pensionale të punëmarrësit	363.33	363.33	
Kontributet pensionale të punëdhënësit	363.33	363.33	
Tatimet në të ardhura personale	211.14	211.14	
Beneficionet tjera	1,575.00	1,575.00	
<b>Gjithsej</b>	<b>12,957.45</b>	<b>12,957.45</b>	
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	1,500.00	1,500.00	
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	1,190.00	1,190.00	
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	498.72	498.72	
Çdo shpenzim tjetër i transportit	-	-	
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>3,188.72</b>	<b>3,188.72</b>	
<b>Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			

**KoalicijaZa Gore***Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2015 deri më 31 Dhjetor, 2015*

Lokali	-	-	
Ushqimi	613.90	613.90	
Aktivitete kulturore dhe rekreative	-	-	
Radio dhe spotet televizive	60.00	60.00	
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	250.00	250.00	
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	1,052.10	1,052.10	
<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>1,976.00</b>	<b>1,976.00</b>	
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
Shpenzimet e fushatës			
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>			
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	508.50	508.50	
Pajisjet të vogla	2,197.50	2,197.50	
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>2,706.00</b>	<b>2,706.00</b>	
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	2,379.00	2,379.00	
Telefoni, interneti dhe posta	2,240.00	2,240.00	
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	560.00	560.00	

**KoalicijaZa Gore***Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2015 deri më 31 Dhjetor, 2015*

Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	-	-	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	-	-	
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>5,179.00</b>	<b>5,179.00</b>	
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	281.10	281.10	
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	662.46	662.46	
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>943.56</b>	<b>943.56</b>	
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>31,500.51</b>	<b>31,500.51</b>	